



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.41/2019

Prishtinë, më 22 janar 2019

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Shemsi Syla, Fisnik Ismaili, Teuta Haxhiu dhe Veton Berisha.

Munguan: Sasha Milosavljeviç dhe Saranda Bogujevci.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Hajrudin Skënderi-Ambasada e Zvicrës; Sanije Berisha, Dhurata Kryeziu-OSBE; Leart Jusufi-KDI; Nora Kelmendi-Ekonomia Online dhe Arberita Marmullaku-RTK.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës për vitin 2018;
3. Shqyrtimi i Draft-planit të punës për vitin 2019;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara

Kryetarja konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura me dt. 26 nëntor, 3, 4 dhe 5 dhjetor 2018, u miratuan pa vërejtje.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës për vitin 2018

Kryetarja, tha se raportin e keni pranuar me kohë. Nga ajo që është pasqyruar në këtë raport, shihet se kemi qenë mjaft aktivë dhe është punuar mirë. aktivitetet e komisionit janë pasqyruar edhe në mënyrë tabelore, pothuajse çdo javë kemi pasur ndonjë takim.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se kemi punuar bashkërisht, është bërë një punë e mirë. Ajo shprehu sërish shqetësimin se në ueb-faqen e Kuvendit, aktivitetet e komisionit prezantohen me vonesë dhe si komision jemi disi të anashkaluar. Më tej, tha se këtë shqetësim duhet ta përcjellim te sekretari i Kuvendit dhe mos të ekzistojnë më këto probleme.

Kryetarja, tha se lidhur me këtë, paraqiten pengesa, sa i përket përkthimit, sepse publikimi duhet të jetë edhe në gjuhën serbe, por theksoi se lidhur me këtë çështje do të bisedojë me sekretarin e Kuvendit.

Lirije Kajtazi, tha se ky komision është i lënë pas dore dhe për këtë kemi disa fakte që mund t'i prezantoj. Ajo, po ashtu, njoftoi se dje si grup parlamentar kanë pasur takim me znj. Apostolova dhe në atë takim ka ngritur shqetësimin e mosmiratimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare, e që Kosovës i duhet si plotësim i standardit për hyrje në UNESKO, e këtë dikush e shfrytëzon edhe politikisht për të penguar plotësimin e këtij kriteri. Këto kërkesa janë shumë diskriminuese për Kosovën.

Kryetarja, tha se disa herë, lidhur me këtë projektligj, ka diskutuar me Grupin Parlamentar të Listës Serbe, por ata janë kundër dhe është e ditur se sa vota kërkohen për miratimin e këtij projektligji.

Veton Berisha, tha se sa i përket raportit të punës nuk ka vërejtje, ndërsa për planin e punës, tha se sa u përket vizitave nëpër komuna, që i bëjnë anëtarët e komisionit brenda këtij viti, është mirë të ndalemi nëpër vendbanime dhe lagje të caktuara, ku jeton komuniteti egjiptian, të dëgjojmë sesi jetojnë ata, sepse edhe sa i përket buxhetit duhet të planifikojmë gjëra konkrete.

Kryetarja, pas hedhjes në votim, konstatoi se Komisioni funksional miratoi Raportin e punës për vitin 2018.

3. Shqyrtimi i Draft-planit të punës për vitin 2019

Kryetarja, tha se kemi një draft të planit të punës, por ne kemi mundësi ta ndryshojmë dhe plotësojmë këtë plan, me propozimet tona. Ajo njoftoi anëtarët e komisionit se ka pasur takim

me përfaqësuesit e OSBE-së, të cilët kanë gatishmërinë ta përkrahin mbajtjen e një punëtorie për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës, por jemi akorduar që kjo të ndodhë pas miratimit të buxhetit për vitin 2019. Po ashtu, kemi pasur edhe një takim me përfaqësues të “Save the Children”, për këtë projektligj, dhe kemi diskutuar për mundësinë e një vizite studimore në njërin nga vendet, ku e ka të avancuar sistemin e mbrojtjes së fëmijëve nga interneti.

Mexhide Mjaku-Topalli, propozoi që shqyrtimi i Projektligjit për peticionet mos të jetë në plan të punës, meqenëse kemi rekomanduar mosmiratimin e këtij projektligji në lexim të parë, në Kuvend. Pas shqyrtimit dhe rezultatit të votimit në parim, në Kuvend, ne vendosim që ta marrim nismën ligjore si Komision funksional për draftimin e këtij projektligji. Ajo propozoi që të caktohet një datë dhe të mbahet një tryezë me të gjithë aktorët, lidhur me zbatimin e strategjisë për personat me aftësi të kufizuara, me qëllimin që koncept-dokumenti për ligjin gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara të procedohet në Kuvend dhe kjo të vendoset në fund të shkurtit.

Po ashtu, ajo propozoi që të mbahet një tryezë e përbashkët me Komisionin për Integritet Evropian dhe të diskutohet për të gjeturat e raportit për Kosovën, për vitin 2018, dhe nga ky diskutim do të mund të identifikonim politikat për vitin pasues. Në këtë takim do t'i kemi prezent edhe ministrat dhe të shohim çka kanë ndërmarrë ata prej publikimit të këtij raporti të vlerësimit për Kosovën.

Po ashtu, ajo propozoi që të vendoset në fund të shkurtit apo në muajin prill, të takohet komisioni ynë me atë të mediave, për të diskutuar lidhur me organizimin e shënimit të masakrës së Dubravës dhe të propozohet që pavijoni C, të shpallet muze.

Në fund, ajo propozoi që Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje, të ndryshohet dhe të plotësohet. Pra, pasi nuk është përfshirë në programin legjislativ të Qeverisë, atëherë është mirë që nismën për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji dhe këtë procedurë ta marrim ne, si komision.

Teuta Haxhiu, tha se ka propozuar vizitat në shtëpinë e komuniteteve në Deçan dhe në Prizren edhe një herë dhe është mirë që të realizohen këto vizita, janë 7 qendra të tilla në Kosovë dhe shqetësimi pse duhet të vizitohen këto qendra, është se janë banorë të moshave të ndryshme dhe shumë prej tyre janë me asistencë sociale ose e kanë të drejtën e pensionit të moshës dhe shqetësimi i personelit është se pensionet nuk u shkojnë direkt atyre banorëve.

Sa i përket projektligjit për shqyrtimin e peticioneve, tha se pajtohet me kolegen, por nuk duhet të ndalemi asnjëherë që komisioni ta procedojë draftin që e kemi, sepse është bërë një punë shumë e mirë dhe është i domosdoshëm.

Lirije Kajtazi, tha se në planin e punës të evidentohet si shënimi i njëzetvjetorit të masakrës së Dubravës, pastaj e konceptojmë sesi do të organizohemi.

Ajo ngriti edhe çështjen e mosprocedimit nga Qeveria të Projektligjit për persona të zhdukur, nuk është në planin e Qeverisë, nuk është përfillur rekomandimi i komisionit për procedim të këtij ligji. Ne duhet të shikojmë dhe të interesohemi lidhur me këtë.

Shemsi Syla, tha se si komision është mirë ta ngremë këtë çështje dhe jo të kërkojmë që të bëhet vetëm shënimi i 20 vjetorit, por të kërkojmë edhe mbajtjen e tryezave, si dhe të kërkojmë që të thirret në Kuvend një seancë e veçantë, që të analizohet edhe njëherë se çka ka ndodhur aty.

Ai tha se duhet të ndryshojmë qasjen, sepse kanë kaluar 20 vjet nga masakra në burgun e Dubravës dhe nuk po shihet shumë rezultat, duhet të aktivizohemi të organizojmë tryeza prezantime, tribuna dhe të aktivizojmë të gjithë mekanizmin tonë, sepse ka përshtypjen se gjithçka po shkon në heshtje.

Kryetarja, tha se shënimin e 20 vjetorit të masakrës së Dubravës, ne po e vendosim në plan të punës dhe pastaj i bashkërendojmë aktivitetet sesi të shënohet kjo ditë.

Kryetarja konstatoi se komisioni do t'i drejtohet me një shkresë Qeverisë, që të shpjegojnë ecurinë se në ç' fazë të procedimit ndodhet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për persona të zhdukur.

Mirjeta Kalludra, tha se përveç këtyre dy ligjeve, që janë paraparë për monitorim, në plan të punës është mirë që, si komision, ta evidentojmë dhe ta monitorojmë edhe një ligj tjetër.

Kryetarja, tha se ligji për mbrojtje nga dhuna në familje duhet të ndryshohet, sepse në terren ka sfida në zbatim dhe duhet ta vendosim në plan të punës.

Mbledhjen e udhëheq nënkryetarja e komisionit, Lirije Kajtazi.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se në planin e punës nuk ishte paraparë ndonjë raportim i ministrave, është mirë që në këtë plan të parashihet për raportim ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, varësisht nga tematika e caktuar.

Lirije Kajtazi, konstatoi se sa i përket planit të punës, për shkak të kohës dhe disa agjendave të anëtarëve të komisionit, do të vazhdojmë shqyrtimin në vazhdimin e kësaj mbledhjeje, për të cilën do të njoftoheni me kohë.

3. Të ndryshme

Anëtarët e komisionit u njoftuan rreth mbajtjes së punëtorisë për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës, dhe sa i përket mundësisë së realizimit të një vizite studimore, lidhur me këtë projektligj, deputetja Teuta Haxhiu propozoi që, nëse është e mundur, të vizitohet Franca, pasi që thuhet se ekziston një sistem i mirë i funksionimit të mbrojtjes së fëmijëve nga interneti.

Lirije Kajtazi, tha se po e përsëriti edhe një herë, që e kemi parë të nevojshme për t'i ftuar në ndonjërin nga mbledhjet e radhës së Komisionit funksional, përfaqësuesit e komisionit për mbledhjen e dëshmive të krimit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje